

UDHËZIM
Nr. 13, datë 9.7.2021

PËR ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN E SESIONIT TË DYTË TË PROVIMEVE TË
MATURËS SHTETËRORE 2021 DHE TË MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE
2021

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 26 dhe të nenit 51, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Lëndët dhe datat e provimeve të Maturës Shtetërore 2021, sesioni i dytë, të jenë:
 - a) Gjuhë e huaj 24 gusht 2021
 - b) Gjuhë shqipe dhe Letërsi 27 gusht 2021
 - c) Matematikë 31 gusht 2021
 - ç) Provimi me zgjedhje 3 shtator 2021
2. Lëndët dhe datat e provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale 2021, sesioni i dytë, të jenë:
 - a) Gjuhë e huaj 24 gusht 2021
 - b) Gjuhë shqipe dhe Letërsi 27 gusht 2021
 - c) Matematikë 31 gusht 2021
 - ç) Teori profesionale e integruar 3 shtator 2021
3. Administrimi i provimeve të Maturës Shtetërore 2021 dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2021, sesioni dytë, bazohet në Rregulloren e Maturës Shtetërore, miratuar me urdhrin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
4. Provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2021 dhe provimet e detyruara të Maturës Shtetërore Profesionale 2021, sesioni i dytë:
 - a) Fillojnë në orën 10:00.
 - b) Provimet e detyruara dhe me zgjedhje zgjasin 2 orë e 30 minuta.
 - c) Testet e provimeve të detyruara dhe me zgjedhje hartohen, administrohen dhe vlerësohen nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA).
5. Në provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2021 dhe në provimet e detyruara të Maturës Shtetërore Profesionale 2021, sesioni i dytë, do të marrin pjesë:
 - a) Maturantët/kandidatët që rezultojnë mbetës në një ose më shumë provime të Maturës Shtetërore 2021 dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2021, sesioni i parë.
 - b) Maturantët që rezultojnë mbetës në një ose dy lëndë në vitin shkollor 2020–2021 dhe i shlyejnë provimet shkollore brenda datës 17 gusht 2021.
 - c) Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme para vitit 2020, por që nuk kanë shlyer detyrimet e Maturës Shtetërore dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2021.
 - ç) Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme jashtë vendit, që kanë të njësuar dokumentet shkollore nga QSHA-ja dhe kanë detyrime të Maturës Shtetërore dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2021.
6. Kandidatët e përcaktuar në pikën 5, shkronjat “c” dhe “ç” të këtij udhëzimi, të regjistrohen në shkollën ku kanë përfunduar arsimin e mesëm ose në shkollën që u cakton Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar/Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar (këtu e në vijim “DRAP/ZVAP”) në vendbanimet e tyre.
7. Maturantët/kandidatët e përcaktuar në pikën 5, shkronja “b”, “c” dhe “ç”, të këtij udhëzimi, të plotësojnë formularin A1Z, për dhënien e provimeve të sesionit të dytë të Maturës Shtetërore dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2021, nëse nuk e kanë plotësuar atë në sesionin e parë. Këta kandidatë të plotësojnë formularin A1Z, në datat 18–20 gusht 2021.

8. Drejtori i institucionit arsimor parauniversitar të dërgojë zyrtarisht në ZVAP, listën e kandidatëve që do të marrin pjesë në provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2021 dhe në provimet e detyruara të Maturës Shtetërore Profesionale 2021, sesioni i dytë, deri më datë 18 gusht 2021. Drejtori i ZVAP-së, ta dërgojë këtë listë në QSHA, në datën 18 gusht 2021.

9. Provimet të zhvillohen të përqendruara në ZVAP. ZVAP-të të përcaktojnë qendrat dhe mjediset ku maturanët/kandidatët do të zhvillojnë provimin, duke mundësuar përqendrimin e tyre, sipas kushteve dhe numrit të maturanëve/kandidatëve.

10. ZVAP-të dhe drejtoritë e institucioneve arsimore parauniversitare, të marrin masa për njoftimin e maturanëve/kandidatëve për datat, qendrën dhe orën kur do të zhvillohet secili nga provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2021 dhe provimet e detyruara të Maturës Shtetërore Profesionale 2021, sesioni i dytë.

11. Drejtori i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar, brenda datës 16 gusht 2021, të njoftojë zyrtarisht QSHA-në dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, për qendrat dhe mjediset ku do të zhvillohen provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2021, sesioni i dytë, dhe për listën e shkollave që marrin pjesë në provimet e Maturës Shtetërore 2021 dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2021, sesioni i dytë. Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar njofton për këto qendra dhe mjedise Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR).

12. Monitorimi dhe administrimi i procesit të Maturës Shtetërore 2021 dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2021, sesioni i dytë, të kryhet nga përfaqësuesit e MASR-së dhe të institucioneve të varësisë.

13. Shpenzimet e përfaqësuesve të MASR-së në monitorimin e provimeve të Maturës Shtetërore 2021 dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2021, sesioni i dytë, të përballohen nga institucionet përkatëse, sipas dispozitave në fuqi.

14. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, Drejtoria e Politikave të Punësimit dhe Aftësimit Profesional, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore arsimore dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
Evis Kushi

MINISTËR I FINANCave DHE EKONOMISË
Anila Denaj